

**Vendim nr. 273 datë 12.11.2024**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryesuese
Illir Toska,	Anëtar
Sandër Beci,	Anëtar

në datën 12.11.2024 mori në shqyrtim paraparak kërkesën nr. 17 (D) 2024 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

**KËRKUES:** DEAR MUÇA

**OBJEKTI:** Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2023-5212, datë 20.12.2023 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Konstatimi i shkeljes/cenimit të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm. Konstatimi i shkeljes së aksesit dhe i sigurisë juridike në një gjykatë të caktuar me ligj.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 42, pika 2, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); ligji nr. 8577/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Sandër Beci, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

## V Ë R E N:

### I

#### Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Dear Muça ka ushtruar profesionin e noterit në Dibër. Ministri i Drejtësisë, bazuar në ankesën e një shtetasi, ka urdhëruar nisjen e hetimit administrativ e më pas të inspektimit të përgjithshëm ndaj veprimtarisë noteriale të kërkuesit për periudhën 2015-2020, me qëllim verifikimin e zbatimit të ligjit nr. 110/2018 “Për noterinë” (*ligji nr. 110/2018*) dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore që rregullojnë dhe zbatojnë noterët gjatë ushtrimit të veprimtarisë. Pas përfundimit të kontrollit, ministri i Drejtësisë ka urdhëruar nisjen e procedimit disiplinor për kërkuesin dhe dërgimin e raportit të hetimit së bashku me dosjen hetimore Bordit Disiplinor të Dhomës Kombëtare të Noterisë (*Bordi Disiplinor*). Ky i fundit, me vendimin nr. 4/2021, datë 26.05.2021 (*vendimi nr. 4/2021*), ka vendosur pranimin e kërkesës për fillimin e procedimit disiplinor, lënien në fuqi të masës disiplinore të propozuar nga ministri i Drejtësisë dhe heqjen përfundimtare të licencës për ushtrimin e profesionit të noterit kërkuesit. Në vijim, me urdhrin nr. 383, datë 17.06.2021 (*urdhri nr. 383/2021*) të ministrit të Drejtësisë, kërkuesit i është hequr përfundimisht licenca e ushtrimit të profesionit të noterit.

2. Kërkuesi ka paraqitur padi në gjykatë, fillimisht, me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 4/2021 të Bordit Disiplinor, si dhe marrjen e masës së sigurimit të padisë duke pezulluar zbatimin e këtij vendimi dhe, më pas, ka shtuar objektin e padisë edhe me kërkimin për shfuqizimin e urdhrin nr. 383/2021 të ministrit të Drejtësisë, si dhe marrjen e masës së sigurimit të padisë duke pezulluar zbatimin e këtij urdhri, me pretendimin se raporti i kontrollit ka qenë i falsifikuar.

3. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, fillimisht, me vendimin nr. 2964 akti, datë 22.06.2021, ka vendosur rrëzimin e kërkesës për marrjen e masës së sigurimit të padisë në lidhje me vendimin nr. 4/2021 të Bordit Disiplinor. Më pas, me vendimin nr. 2964 (31155-03342-80), datë 29.09.2021, ajo gjykatë ka vendosur rrëzimin edhe të kërkesës tjetër për marrjen e masës për sigurimin e padisë. Ky vendim, mbi ankimin e kërkuesit, është lënë në fuqi nga Gjykata Administrative e Apelit me vendimin nr. 29, datë 05.08.2022, ndërsa Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-792, datë 15.03.2023, ka vendosur mospranimin e rekursit të veçantë të kërkuesit.

4. Në vijim, në përfundim të gjykimit të themelit të çështjes, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 2953 (80-2021-2995), datë 26.10.2021, ka vendosur

rrëzimin e padisë së kërkuesit. Kundër këtij vendimi kërkuesi ka paraqitur ankim në datën 25.11.2021 dhe çështja është regjistruar për gjykim në Gjykatën Administrative të Apelit me nr. 31155-03951-86-2021, datë 15.12.2021.

5. Në datën 23.10.2023 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë me objekt konstatimin e shkeljes dhe përshpejtim të procedurave për gjykimin e çështjes nga Gjykata Administrative e Apelit, për shkak të kalimit të afatit 1-vjeçar të gjykimit të çështjes nga ajo gjykatë. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, pasi ka marrë informacion nga gjyqtarja relatores në Gjykatën Administrative të Apelit, me vendimin nr. 00-2023-5212, datë 20.12.2023, ka vendosur rrëzimin e kërkesës së kërkuesit, me arsyetimin se ajo gjykatë gjendet në pamundësi objektive për të marrë në shqyrtim çështjen e kërkuesit nisur nga volumi i madh i çështjeve të mbetura pa gjykuar përpara asaj gjykate për një kohë të gjatë, në raport me një pamjaftueshmëri burimesh njerëzore për të përballuar këtë volum, situatë e cila del përtej rastit individual dhe ka të bëjë me një problematikë që përfshin sistemin në tërësi.

6. Në datën 23.08.2024 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij. Në lidhje me afatin për shqyrtimin paraprak të çështjes, të përcaktuar në nenin 47, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, bazuar në nenet 15, pika 2 dhe 21, pika 1, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, në këtë afat nuk llogaritet periudha e lejes vjetore të anëtarëve të Gjykatës, sipas nenit 18, pika 1, shkronja “b”, të po këtij ligji.

## II

### Pretendimet e kërkuesit

7. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar *e drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, në drejtim të:

7.1. *Së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm nga gjykata e apelit*, pasi ankimi në gjykatën e apelit është depozituar në datën 25.11.2021 dhe deri në datën 23.08.2024, kur ai ka paraqitur kërkesën për shkelje të afatit të arsyeshëm nga Gjykata Administrative e Apelit, kanë kaluar pothuajse 3 vjet. Gjykata e Lartë në vendimmarrjen e saj nuk ka mbajtur në konsideratë se zvarritja e procesit në gjykatën e apelit ka impakt të drejtpërdrejtë në të drejtën profesionale dhe intelektuale pronësore të kërkuesit.

7.2. *Së drejtës së aksesit*, pasi Gjykata Administrative e Apelit ende nuk e ka shqyrtuar çështjen.

7.3. *Parimit të sigurisë juridike*, pasi Gjykata e Lartë nuk ka marrë në konsideratë jurisprudencën kushtetuese dhe evropiane, sipas të cilave *vettingu* në drejtësi dhe mungesa e gjyqtarëve nuk mund të justifikojnë mosshqyrtimin në kohë të çështjes.

### III

#### Vlerësimi i Kolegjit

##### A. *Për legjitimitimin e kërkesit*

8. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të parashikuara në nenin 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

9. Në kuptim të dispozitave të mësipërme, individ, si subjekt i kushtëzuar, mund të paraqesë ankim kushtetues individual vetëm për çështje që lidhen me interesat e tij të drejtpërdrejta, duke provuar se është cenuar në të drejtat e tij kushtetuese, pra se është viktimë e një shkeljeje dhe se pasojat nga akti i kundërshtuar janë të drejtpërdrejta dhe reale për të. Gjykata ka pohuar se, në parim, statusi i “viktims” përjashtohet vetëm nëse organet publike kanë njohur shkeljen, në mënyrë të shprehur ose në substancë, dhe më pas e kanë riparuar atë (*shih vendimet nr. 64, datë 30.11.2023; nr. 44, datë 26.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Kërkesi në objektin e kërkesës në shqyrtim, në thelb, ka kërkuar si shfuqizimin e vendimit nr. 00-2023-5212, datë 20.12.2023 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, me të cilin është vendosur rrëzimi i kërkesës për konstatimin e afatit të arsyeshëm për shqyrtimin e çështjes në Gjykatë të Apelit, ashtu edhe konstatimin e cenimit të kësaj të drejte. Referuar të dhënave në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë rezulton se çështja e themelit të kërkesit është

regjistruar përpara kësaj gjykate, mbi rekursin e tij, në datën 22.10.2024, me nr. 31001-00511-00-2024. Kjo do të thotë se Gjykata Administrative e Apelit përpara kësaj date (22.10.2024) dhe pas paraqitjes së ankimit kushtetues individual të kërkuarit (23.08.2024) në Gjykatë ka përfunduar së gjykuari çështjen e tij.

11. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se, si rregull, për sa i përket cenimit të së drejtës për proces të rregullt për shkak të tejzgjatjes ose zvarritjes së procedurave, mjeti efektiv për konstatimin e cenimit dhe përshpejtimin e procedurave i përket gjyqësorit të zakonshëm, ndërkohë që Gjykata investohet vetëm për riparimin e shkeljeve të kryera nga ato gjykata, në rast se ato nuk janë në gjendje të korrigjojnë dhe riparojnë shkeljen e së drejtës për proces të rregullt, pra në rast se provohet se mjeti juridik nuk ka qenë efektiv. Gjithashtu, ajo ka pohuar se mjetet e parashikuara nga nenet 399/1 e vijues të KPC-së synojnë të garantojnë të drejtën kushtetuese të individit për zhvillimin e procedurave/gjykimit brenda një afati të arsyeshëm, duke siguruar: i) parandalimin e shkeljes, në kuptimin që në një çështje konkrete, e cila është duke zgjatur në kohë, të urdhërohet përshpejtimi i procedurave në mënyrë që individit të mos i cenohet e drejta për gjykim brenda afatit të arsyeshëm; ii) riparimin e shkeljes nëpërmjet përfundimit të procedurave sa më shpejt të jetë e mundur dhe, eventualisht, caktimit të një dëmshpërblimi. Këto mjete juridike janë të ndërlidhura me njëra-tjetrën në mënyrë subsidiare, pra në atë mënyrë që, në rast se mjetet parandaluese nuk kanë qenë efektive për shmangien e shkeljes përmes përshpejtimit të procedurave, atëherë ato i lënë vend aplikimit të mjeteve riparuese kompensuese të kësaj vonese (*shih vendimin nr. 11, datë 28.02.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Në kuptim të sa më sipër, përderisa Gjykata Administrative e Apelit e ka marrë në shqyrtim çështjen e kërkuarit, Kolegji vlerëson se ai e ka humbur statusin e viktimës në drejtim të riparimit të shkeljes përmes përshpejtimit të procesit, ndaj nuk legjitimohet *ratione personae* për paraqitjen e ankimit kushtetues individual.

13. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

**V E N D O S I:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.